



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1140\_05\_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 23.06.2014.

**në seancën e mbajtur më datë 30 qershor 2014, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHE** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F. K., me shifër të konsumatorit: DFE - 2001267) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1140\_05\_14 i datës 19.05.2014.

**Arsyetim**

Konsumatori Xh.K. me datë 13.08.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS, me të cilën ka kontestuar borxhin e krijuar nga ish pronari i kësaj prone, gjithashtu i njëjti ka theksuar se kërkon që njehsori t'i regjistrohet në emrin e tij.

Pas ankesës së konsumatorit Departamenti për Konsumator në KEK me datë 23.08.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se për ndërrim emri duhet të paguhet borxhi në tërësi dhe se me rastin e shitblerjes së pronës duhet të paguhet borxhi në tërësi.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-u ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të konsumatorit. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 19.05.2014 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që: i) të shkarkoi konsumatorin M.K. nga borxhi i energjisë elektrike në shifrën DFE - 2001267 deri në periudhën kohore 02/2012, dhe këtë borxh ta realizoi në procedurë gjyqësore nga personat që e kanë krijuar, pranë gjykatës kompetente; ii) pas marrjes së veprimit si në pikën 1 të këtij vendimi duhet t'i ndërroi emrin e konsumatorit të tanishëm në shifrën DFE - 2001267 dhe tani e tutje faturat e energjisë të dërgohen në emër pronarit të ligjshëm M.K.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, për faktin se lidhja juridike për shërbimin me energji elektrike ekziston mes F. K. dhe KEDS-it dhe se M. K. nuk është fare konsumator i KEDS-it. Në ankesë po ashtu theksohet se sipas nenit 3 të kontratës së



shitblerjes së paluajtshmërisë H. dhe E. K. në cilësinë e shitësit e vunë në kurth M. K. duke e garantuar se nuk ka kurrfarë barre juridike ndaj personave të tretë, andaj duke marrë për bazë këtë M. K. duhet ta realizoj interesin e vet juridik përmes rrugës gjyqësore ndaj shitësve të pronës e jo ndaj KEDS-it.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30 qershor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje dhe se cilën dispozitë ligjore e ka shkelur. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike nga perioda e faturimit 01/2007 deri në periudhën e muajit 02/2012, ku parashtuesi i ankesës ka blerë pronën siç vërtetohet me kontratën e shitblerjes së paluejtshmërisë, borxhi i energjisë elektrike ka qenë në vlerë financiare prej 1265.84€.

Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se kontrata e shitblerjes së paluejtshmerisë e lidhur me datë 09.02.2012 në mes të H. I. K. dhe E. I. K. në cilësinë e shitësit në njërin anë dhe M. K. në cilësinë e blerësit në anën tjetër, është e lidhur dhe e vërtetuar në gjykatë, dhe se sipas nenit 3 të kësaj kontrate është evidentuar se shitësi i garanton blerësit se në paluajtshmëritë e blera të përshkruar detalisht si në nenin 1 të kësaj kontrate nuk ekziston kurrfarë barre juridike nga personat e tretë. Sipas kësaj kontrate blerësi i pronës M. K. nga data 09.02.2012 është pronar i ligjshëm i pronës së cekur më lartë dhe se nga ajo datë e tutje pronari i ligjshëm i bart të gjitha shpenzimet, e në këtë rast shpenzimet e energjisë elektrike, ndërsa shpenzimet e energjisë elektrike të krijuara deri më datën e kontratës duhet t'i bart shitësi.

Mbështetur në nenin 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifatat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Po ashtu mbështetur në nenin 5 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve”*, andaj KEK në këtë rast nuk ka vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk ka arritur të inkasoj borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull, por ka kërkon borxhin nga personat tjerë tani të ligjshëm të asaj prone.

Bordi i ZRRE ka konstatuar se në momentin kur KEDS-i e detyron konsumatorin tani të ligjshëm për pagesën e borxhit të energjisë elektrike të krijuar para lidhjes se kontratës se shitblerjes se paluejtshmërisë e për të cilën vlerë konsumatori nuk e ka shpenzuar ka rënë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi, pasi që këtë borxh nuk ka arritur të argumentoj se është borxh i krijuar nga ky konsumator dhe se të njëjtin mund ta kërkojë në procedurë gjyqësore nga personi që e ka krijuar.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1140\_05\_14, dhe pas analizimit të hollësishtë të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar